



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË**

Nr. 3556/10 prot

Datë, 23/07/2018

VENDIM

Nr. 17 Datë 12/07/2018

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR(PUS-SHPIM) AUTOSTRADA TIRANË –DURRËS KM.7 PËR SUBJEKTIN “QTU”SHPK
PËR QËLLIME SANITARE.**

Në mbështetje të ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" neni.41 pika 1 gërma "e" neni.50 pika 2; Vendimin Nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" neni 11 pika 3, dhe vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 7 pika 3, neni 16; Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorimin e burimit ujor nëntokësor (pus-shpim) me aktivitet njësi tregtare për qellime sanitare për subjektin "QTU" shpk me administrator Znj.Satbere Hoxha, me adresë; autostrada Tiranë - Durrës km.7,njësia administrative Kashar Tiranë, me këto të dhëna:
 - Koordinatat: X 45 80 825 Y 43 95 545 Z 46 m
 - Kapaciteti i pusit 0.005 m³ /s (5 l/s)
 - Thellësia e pusit 36 m
 - Volumi maksimal i ujit që kërkohet 2.5 l/s
 - Sasia që do jepet në përdorim : 2.5 l/s
 - Qëllimi i përdorimit : Ujë sanitar
 - Vendi shkarkimit të ujrave të përdorura Kanali i ujrave të zonës; gropë septike.
2. Ngarkohet ABU Ishëm-Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

